Kronikë

Dibër/ Parandalohet ngjarja kriminale, arrestohet 20-vjeçari me kallashnikov dhe municione luftarake në makinë

Policia e Dibrës ka parandaluar një ngjarje të rëndë kriminale, duke vënë në pranga një 20-vjeçar, i identifikuar si Luiz Dikollari. Ai qarkullonte me automjet me targa të huaja dhe shasi të dëmtuar, i armatosur me armë zjarri me kallashnikov, i pajisur me doreza dhe një bidon 20 litra me benzinë.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

[Sh.com] Redaksia
17 Nëntor, 11:15 | **Përditesimi: 17 Nëntor, 11:25**

Share

Policia e Dibrës ka parandaluar një ngjarje të rëndë kriminale ditën e sotme, duke vënë në pranga një 20-vjeçar.

Në kuadër të operacionit policor të koduar "Inteligjenca" shërbimet operacionale dhe patrullat e Përgjithshme kanë ndaluar automjetin dyshuar tip "Benz", me targa të huaja që drejtohej nga 20-vjeçari me inicialet L.D., banues në fshatin Brezhdan, Dibër.

Sipas policisë, i riu qarkullonte me automjet me targa të huaja dhe shasi të dëmtuar, i armatosur me armë zjarri me kallashnikov, i pajisur me doreza dhe një bidon 20 litra me benzinë.

[Sh.com]
LEXO EDHE:
Dibër/ 60-vjeçari përplaset për vdekje, drejtuesi i mjetit largohet nga vendi i ngjarjes! E bija në lot: O babi im (VIDEO)

> *'Gjatë kontrollit brenda në automjet, shërbimet e Policisë i gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri kallashnikov me krehër e **municion luftarak**, dhe një bidon me lëndë djegëse benzinë dhe një palë doreza', njoftoi sot policia.*

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për veprime të mëtejshme.

S.B/Shqiptarja.com

TAG: municion luftarak | Dibër

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:

16 Nëntor, 09:13

Kush ka pension më të ulët bonus më të madh në fundvit? Si e vlerësoni?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Mat/ Gjendet lëndë plasëse artizanale në lulishten e qytetit të Burrelit, forcat xheniere shkojnë për ta çaktivizuar! Hetime për autorët
14 Nëntor, 12:09

Dekonspiroi operacionet e policisë dhe u përfshi në trafik droge, arrestohet efektivi i Dibrës (EMRI)
11 Nëntor, 21:00

Bulqizë/ 50 vjeçari u aksidentua gjatë punës në galerinë e minerës, nisin hetimet për administratorin e firmës
11 Nëntor, 12:50

Bulqizë/ Shoferi humbet kontrollin e mjetit, makina bie në lumë (VIDEO)
10 Nëntor, 14:25

Dibër/ Maturantët rikthehen pas 25 vitesh në shkollën e mesme në Zerqan, ish- nxënësit e gjejnë të rrënuar

Mahir Jangulli

3 Nëntor, 16:00

Dibër/ I kërkonin para për të mos i publikuar foto e video intime në rrjetet sociale! Arrestohet çifti dhe një adoleshente që shantazhonin 17-vjeçaren
31 Tetor, 13:20

Mat/ Pas një viti betejë me sëmundjen, ndërron jetë prifti i kishës katolike don Gianfranco Cadenelli
30 Tetor, 22:44

Bulqizë/ Arrestohet 33 vjeçari, nuk iu bind urdhrit të policisë! Gjatë kontrollit iu gjet sasi lënde narkotike
25 Tetor, 08:44

Kultivoi kanabis në një fshat të Matit, arrestohet 33-vjeçari! Në hetim kryeplaku
24 Tetor, 09:58

Aksident në aksin Peshkopi-Maqellarë/ Makinat përplasen me njëra-tjetrën, 1 i plagosur
23 Tetor, 10:49

E rëndë në Burrel/ Banesa përfshihet nga flakët, 41 vjeçarja ndërron jetë si pasojë e asfiksimit nga tymi
21 Tetor, 10:56

Skrapar/ Iu gjet në banesë 6.4 kg kanabis dhe 1 armë zjarri, në pranga 33-vjeçari (EMRI)
18 Tetor, 15:12

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje